# DËSHMI ARKIVI

**A-469455**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rama pas incidentit me vezë në New York: Protestat nuk më ndalin, flamurin do ta çoj në Europën e Bashkuar |
| ADRESA | `https://albeu.com/lajme/rama-pas-incidentit-me-veze-ne-new-york-protestat-nuk-me-ndalin-flamurin-do-ta-coj-ne-europen-e-bashkuar/1027397/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 15:52:05 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 15:47:01 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `b508e84287914993bac3bc5bdee020cffabad73711d4da6303c8fc2ed121af25` |
| TEKSTI | `9fee3eee18d77225a3b60526236e01a2e8f15d4afa94626f04df71a23ded7949` |
| PAMJA | `febc12c47dd9bea16736bf25b97f95ab00e7c3e57013214e4c1c7d1c506b7476` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `c8a107d2e3d48575115478a3a9118de6da4284f2c42ca4216f1ff9db12f9b33f` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `77d68db3023b2e51e8611bf6d5eddb24bf36cfc38da7912fff4d1353a313a25f` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c8a107d2e3d48575115478a3a9118de6da4284f2c42ca4216f1ff9db12f9b33f`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Rama pas incidentit me vezë në New York: Protestat nuk më ndalin, flamurin do ta çoj në Europën e Bashkuar



Kryeministri Edi Rama ka reaguar në platformën “X” pas incidentit të ndodhur në New York, ku protestues shqiptarë i hodhën vezë gjatë vizitës së tij në SHBA.

Përmes mesazhit të tij, Rama iu kundërpërgjigj protestuesve me tone të ashpra, duke theksuar se veprime të tilla nuk do ta pengojnë të vijojë misionin e tij politik. Ai deklaroi se nuk do të tërhiqet përballë kritikave dhe protestave, pasi synimi mbetet integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Kryeministri e lidhi këtë proces me luftën kundër korrupsionit dhe reformën në drejtësi. Sipas tij, Shqipëria e sotme nuk është më vendi i së kaluarës, ndërsa sistemi institucional ka nisur të tregojë aftësi për vetëpastrim.

Rama tha se flamuri kombëtar është ngritur prej tij “më lart se ç’ka qenë ndonjëherë” në sytë e botës. Ai shtoi se nuk mund të ndalet nga balta, vezët apo “jargët” në përpjekjen për ta çuar flamurin shqiptar në “majën e Europës së Bashkuar”.

Ai u shpreh se krijimi i një sistemi institucional që lufton korrupsionin dhe zbaton barazinë para ligjit përbën, sipas tij, një arritje të rëndësishme të misionit të tij politik. Rama argumentoi se një vend i zhytur në korrupsion nuk do të kishte luftë frontale dhe rezultate konkrete kundër tij, ndërsa Shqipëria, në vlerësimin e tij, tashmë ka ndryshuar.

Kryeministri pretendoi gjithashtu se Bashkimi Europian e vlerëson gjithnjë e më shumë Shqipërinë për përpjekjet kundër korrupsionit. Në fund të reagimit, ai përdori epitete ironizuese për protestuesit dhe kritikët e tij, duke i cilësuar si “pula histerike të katundit tonë” që hedhin vezë në ajër në interes të “gjelave tallagjarë të pazarit politik e mediatik”.

Rama i akuzoi kundërshtarët se besojnë se mund ta mposhtin përmes akuzave të vazhdueshme për

të fundit/


FOTO/ Dakota Johnson shkëlqen në premierën e “Verity” me një fust…


Maran debuton zyrtarisht me Shqipërinë, kuqezinjt…


Nga drejtues i Austrisë në kundërshtar, Rangnick vlerëson…


“Rreth 15 mijë dollarë nata”/ Marjana Koçeku: Rama shpenzon sa 5…


66-vjeçari nga Koçani dorëzoi 18.000 euro për “heqjen” e magjisë së…


Përplasje mes taksisë dhe furgonit me mësues në aksin…


Kuvendi mblidhet të hënën, në rend dite deklarata për…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Rama i akuzoi kundërshtarët se besojnë se mund ta imponojnë përmes akuzave të vazhdueshme për korrupsionin, për të cilin ai tha se po luftohet nga vetë sistemi që po ndërtohet, si edhe përmes sharjeve dhe mallkimeve. Ai ironizoi edhe mënyrën e shkrimit të njërit prej kritikëve, duke thënë se "e shkruan shqipen me këmbët e pulës".

Shtuar më 25.09.2026 17:47

Tags: -Politikë , kryesorë , Lajmet e fundit , Shqiperia , Të Gjitha , ZZ-Instant


"Rreth 15 mijë dollarë nata"/ Marjana Koçeku: Rama shpenzon sa 5 vite…


Përplasje mes taksisë dhe furgonit me mësues në aksin Lezhë-Shkodër,…


Rama në Nju Jork: Shqipëria po krijon imunitet ndaj korrupsionit, dikur lu…


Tre të plagosur pas përplasjes së dy makinave në aksin Elbasan-Peqin


Oltjon Muzaka largohet nga Shëndetësia dhe emërohet zv.ministër i Punëve të…


Mbërrin në Shqipëri ambasadori i ri i SHBA, Eric Wendt i dorëzon nesër…


Këshilli Bashkiak i Tiranës fton Erion Veliajn në mbledhje, kërkesë SPAK-…


Bardhi kërkon llogari nga Begaj për dekretimin e Vlora Hysenit: Shqiptarët…

albeu që nga viti 2003 © 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko... Kërko

**Kryesore**
Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

**Kategori**
Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

**Linqet**
Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

**Tags**
Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

**Moti**
Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.